



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 382/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.09.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-58421-05-18-2020, me objekt Loti 6 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1030 (Forcat Tokësore)”, me fond limit 103.109.842 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f.
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.1, ambienti brenda Kryeministrisë, kati përdhe, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, Nr. 3, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.05.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-58421-05-18-2020, me objekt Loti 6 “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1030 (Forcat Tokësore)*”, me fond limit 103.109.842 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 17.07.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 31.07.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. BOE “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f. | 84.589.400 lekë, skualifikuar |
| 2. “Dion - AL” sh.p.k. | 102.885.200 lekë, kualifikuar |

II.4. Në datën 31.07.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Gustoso" sh.p.k. & "Bland Ashiku" p.f. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

- BOE "Gustoso" + "Bland Ashiku" nuk plotëson nënpikat 1, 2, 3 dhe 4 të seksionit 3.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave nuk arriti të paraqesë certifikatat ISO 9001, ISO 22000, ISO 18001-ose ISO 45001 dhe ISO 14001 të përkthyer në gjuhën shqipe.
- BOE "Gustoso" + "Bland Ashiku", nuk plotëson nënpikën 2 të seksionit 3.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi Operatori Ekonomik "Bland Ashiku" në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.
- BOE "Gustoso" + "Bland Ashiku", nuk plotëson nënpikën 4.1 të seksionit 3.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi Operatori Ekonomik "Bland Ashiku" në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për dy shoferat; certifikatën e kualifikimit origjinale ose kopje të noterizuar të saj për kuzhinierin B.A.; ndërsa për kuzhinierin K. H. dhe ndihmës kuzhinierët/shërbyesit e gatimit D.L, D.H. dhe E.T. nuk arriti të provojë eksperiencën 1 vjeçare në punë sipas profesioneve përkatëse.

II.5. Në datën 06.08.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Gustoso" sh.p.k. & "Bland Ashiku" p.f. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon:

"1.Persa i perket pretendimit te ngritur se BOE "Gustoso" sh.p.k dhe Bland Ashiku nuk e ploteson kriterin apo nuk arriti te paraqese certifikatat ISO 9001, ISO 22000, ISO 18001, ISO 45001 dhe ISO 14001 te perkthyer ne gjuhen shqipe nuk qendron.

Ky pretendim i Autoritetit Kontraktor se certifikatat ISO duhet te jene te perkthyer ne Gjuhen Shqipe eshte nje kriter i pabazuar ne kriteret ligjore dhe per me shume ne kundërshtim me dokumentat standard te tenderit. Ne VKM 914, date 29.12.2014 "Per Prokurirnin Publik", i ndryshuar, ne nenin 14, pika 2, percaktohet ne menyre te qarte se "Ne rastin e procedurave te prokurimit mbi kufijte e larte monetare, dokumentet e tenderit duhet te hartohen ne gjuhet shqip dhe anglisht. Operoret ekonomike mund te paraqesin ofertat e tyre ne gjuhet shqip ose anglisht. "Ne Dokumentat Standarde te Tenderit ne pika 4.6 - Gjuhet per hartimin e kerkesave ose ofertave mund te jene ne Shqip ose Anglisht. Sa me siper arsyeja e pretenduar nga Autoriteti Kontraktor nuk qendron dhe eshte ne kundërshtim me percaktimet e dispozitave ligjore, prandaj kerkojme rrezimin e ketij pretendimi.

2. Persa i perket motivacionit se BOE "Gustoso" dhe "Bland Ashiku" nuk ka paraqitur dokumentacionin per ambientin, sqarojme se, ne dokumentat standard te tenderit eshte kerkuar, Nenit 3.3, "Kapacitetet Teknike", pika 2, se "Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient, ku ushtron veprimtarine e shërbimit dhe gatimit te ushqimit, per te cilat duhet te paraqese dokumentacion ...". Ne keto kushte ambienti per realizimin e ketij shërbimi eshte vene ne dispozicion nga lideri i ketij bashkepunimi operatori ekonomik "Gustoso" sh.p.k. Ne kete rast ne dst eshte kerkuar qe te paraqitet vetem nje ambient dhe jo ambient per cdo operator qe kane lidhur marreveshje bashkepunimi. Vendorsja e ambientit ne funksion te realizimit te qellimit

objekt prokurimi eshte vendosur edhe ne marreveshjen e bashkepunimit e realizuar midis dy operatoreve ekonomik te cilet krijuan kete bashkepunim operatoresh me qellim pjesemarrjen ne kete procedure. Ne marreveshjen e bashkepunimit, seksioni kushtet e kontrates, pika 1.2, citohet se: "1.2 Te pranoje kryerjen e gjithë sherbimit ne masen 5 % te vleres se tij te tenderuar prej bashkimit te operatoreve ekonomike dhe te vere ne dispozicion te bashkimit te operatoreve ekonomik ambientin ne te cilin do te kryhet sherbimi".

Ne keto kushte kriteri i vendosur ne DST eshte plotesuar nga bashkimi i operatoreve ekonomik pasi BOE (operatori ekonomik "Gustoso" dhe Ashiku Bland) ka vene ne dispozicion ambientin e tij dhe ka depozituar te gjithë dokumentacionin e nevojshem per plotesimin e ketij kriteri.

3. Ne lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se nuk arriti te paraqesë dokumentin original apo kopje te noterizuar per kuzhinierin B.A. bie ne kundërshtim me aktet ligjor si dhe praktiken e ndjekur deri me tani edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Ne zbatim të Manualit nr.1, date 26.01.2018 "Per regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit publik" thuhet se "Dokumentat e skanura duhet të jenë origjinale ose kopje të skanuara, version i skanuar I këtyre dokumentave pasi hidhet në sistemin e prokurimit elektronik, për një procedure konkrete është I barazvlefshem me dokumentin original".

Dokumenti jone eshte skanuar ne versionin bardhe e zi dhe ne zbatim edhe me Udhezimin e APP nr. 3, date 09.05.2017 "Per shqyrtimin dhe Vleresimin e Ofertave me Prokurim me Mjete Elektronike" parashikohet se "Operatori ekonomik para se te lidhet kontrata i kerkohet te paraqese dokumentacionin administrativ ligjor ne forme te shkruar te paraqitur ne tender. Ky interpretim dhe qendrim eshte mbajtur edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik ne Vendimin e tij Nr.487/2018 ne te cilin shprehet se "Komisioni gjykon se procesi i dorezimit te dokumenteve prej operatoreve ekonomik ne SPE lidhet me konvertimin e tyre nga hard copy ne informacion dixhital (elektronik), informacion ky tashme i aksesueshem vetem nepermjet kompjuterit dhe per te cilin nuk ka kuptim gjykimi I origjinalitetit dhe askush nuk mund te gjykoje nese nje dokument ne format elektronik eshte kopje apo origjinale. Per me teper qe operatorët ekonomik ne procedurat e prokurimit ne te cilat marrin pjese, dorezojne deklarata mbi pergjegjesine që ata mbajne per dokumentacionin që paraqesin.

4. Persa i perket pretendimit se nuk ka depozituar dokumentacionin justifikues per dy shoferet, argumentojme se per keta punonjes BOE ka paraqitur lejet e drejtimit, kontrata pune dhe libeze pune per stafin e sipercitur. Pavaresisht se per nje nga punonjesit kontrata eshte lidhur per te kryer funksione si Kryekamariet, dokumentacioni i dorezuar ploteson kriterin pasi deshmohet qe punonjesit e stafit jane me kontrata te rregullta pune dhe kane deshmi per drejtimin e automjeteve sipas kategorive te kerkuara ne dst.

5. Se fundmi ne lidhje me pretendimin se Kuzhinieri/ndihmes kuzhinier/sherbyes gatimi K.H. D.L, D.H. E.T nuk arriti te provoje eksperiencen I vjecare te punes ju sqarojme se keta punonjes kane esperiencen e kerkuar ne dokumentat standard te tenderit dhe per te vertetuar kete fakt po ju veme ne dispozicion vertetimin e leshuar nga e-albania qe verteton se stafi e ploteson kete kriter.

Duam te theksojme se oferta e shoqerise tone eshte me leverdi ekonomike se te gjitha ofertat e tjera duke kursyer buxhetit te shtetit rreth 20,000,000 (njezet milion) milione leke.

Persa me siper si dhe bazuar ne ekprienccen tone shumevjecare ne kete sektor duke realizuar me sukses kontrata te ngjashme ne sektorin publik kerkojme pranimin e kerkeses tone dhe kualifikimin e ofertes si te vlefshme dhe me cmimin me te ulet."

II.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.1558/3 prot, datë 13.08.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f., duke e pranuar pjesërisht atë me argumentimin si më poshtë:

[...]

1.Ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF ka ankimuar skualifikimin per mospermbushjen e kriterit ne shtojcen nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.1

"Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike" pika 1, 2, 3, 4 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: "1. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate te vlefshme qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001 ose ekuivalent i tij. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. 2. Certifikate e vlefshme e shoqerise ISO 22000 ose ekuivalent i tij - Sistemet e menaxhimit te sigurise ushqimore. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te korformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. 3. Certifikate e vlefshme qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001-ose ISO 45001 ose ekuivalent i tij. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. 4.Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten te vlefshme ISO 14001 ose ekuivalent i tij - Sisteme te menaxhimit te mjedisi. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise" me pretendimin si vijon: [...] ISO 45001 dhe ISO 14001 te perkthyer ne gjuhen shqipe nuk qendron. Ky pretendim i Autoritetit Kontraktor se certifikatat ISO duhet te jene te perkthyer ne Gjuhen Shqipe eshte nje kriter i pabazuar ne kriteret ligjore dhe per me shume ne kundershtrim me dokumentat standard te tenderit.

Ne VKM 914, date 29.12.2014 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, ne nenin 14, pika 2, percaktohet ne menyre te qarte se "Ne rastin e procedurave te prokurimit mbi kufijte e larte monetare, dokumentet e tenderit duhet te hartohen ne gjuhet shqip dhe anglisht. Operatoret ekonomike mund te paraqesin ofertat e tyre ne gjuhet shqip ose anglisht "Ne Dokumentat Standarde te Tenderit ne pika 4. 6 - Gjuhet per hartimin e kerkesave ose ofertave mund te jene ne Shqip ose Anglisht. Sa me siper arsyeja e pretenduar nga Autoriteti Kontraktor nuk qendron dhe eshte ne kundershtrim me percaktimet e dispozitave ligjore, prandaj kerkojme rrezimin e ketij pretendimi."

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF, pretendimet e parashtruara ne ankesa mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se:

Per ofertuesin BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 31.07.2020, arsyet e skualifikimin re ofertes se tij si vijon: "BOE "Gustoso" + "Bland Ashiku" nuk ploteson nenpikat 1, 2, 3 dhe 4 te seksionit 3.3 te kriterëve te vecanta te kualifikimit, pasi ne

momentin e hapjes se ofertave nuk arriti te paraqese certifikatat ISO 9001, ISO 22000, ISO 18001- ose ISO 45001 dhe ISO 14001 te perkthyer ne gjuhen shqipe. "

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF dhe konstatoi:

Ne dokumentat e tenderit ne kriterin ne shtojcen nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike" pika 1, 2, 3, 4 percaktohet se: 1.Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate e vlefshme qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001 ose ekuivalent i tij. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. 2.Certifikate e vlefshme e shoqerise ISO 22000 ose ekuivalent i tij - Sistemet e menaxhimit te sigurise ushqimore. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. 3.Certifikate e vlefshme qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001- ose ISO 45001 ose ekuivalent i tij. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. d.Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten te vlefshme ISO 14001 ose ekuivalent i tij - Sisteme te menaxhimit te mjedisi. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF ka dorezuar dokumentacionin me emertim "8_ISO_Bland Ashiku" dhe "6_ISO". Pjese e ketij dokumentacioni jane certifikata qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001; Certifikate ISO 22000 per sistemet e rrenaxhimit te sigurise ushqimore; Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001 dhe certifikatea ISO 14001 per Sisteme te menaxhimit te mjedis, per subjektin "Gustoso" SHPK dhe "Bland Arshiku" PF. Certifikatat ISO te paraqitura jane ne gjuhet italisht dhe anglisht.

Ne "Njoftimin e Kontrates", seksioni 4 "Procedura", ne piken 4.6 "Gjuha (-et) per hartimin e oferteve ose kerkesave per pjesemarrje" percaktohet se jane gjuhet shqip dhe anglisht. Per rrjedhoje dokumentacioni i dorezuar nga ofertuesi rezulton se ploteson kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Per arsytet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF pranohet.

2. Ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF ka ankimuar skualifikimin per mospermbushjen e kriterit ne shtojcen nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.2 "Kapaciteti teknik" pika 2 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit, per te cilin duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem: Dokumentacionin qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen si me poshte: Dokumentacioni qe verteton pronesine. -Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes/ose kontrata e dhurimit ose cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise. Dokumentacioni qe verteton huaperdorjen: - Kontrate huaje. Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira. - Kontrate qiraje.

a) Licencen e kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez ", leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit. b) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.I.A, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, per zhvillimin e aktivitetit te gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, per kete ambient. c) Akt miratimi higjeno - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. d) Certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. e) Operatori ekonomik duhet te deklaroje plotesimin e standarteve tekniko-teknologjike per ambientin ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit. " me pretendimin si vijon: [...] Persa i perket motivacionit se BOE "Gustoso" dhe "Bland Ashiku" nuk ka paraqitur dokumentacionin per ambientin, sqarojme se, ne dokumentat standard te tenderit eshte kerkuar, Nenit 3.3, "Kapacitetet Teknike", pika 2, se "Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit, per te cilat duhet te paraqese dokumentacion...". - Ne keto kushte ambienti per realizimin e ketij sherbimi eshte vene ne dispozicion nga lideri i ketij bashkepunimi operatori ekonomik "Gustoso II sh.p.k. Ne kete rast ne dst eshte kerkuar qe te paraqitet vetem nje ambient dhe jo ambient per cdo operator qe kane lidhur marreveshje bashkepunimi. Vendosja e ambientit ne funksion te realizimit te qellimit objekt prokurimi eshte vendosur edhe ne marreveshjen e bashkepunimit e realizuar midis dy operateve ekonomik te cilet krijuan kete bashkepunim operatoresh me qellim pjesemarrjen ne kete procedure. Ne marreveshjen e bashkepunimit, seksioni kushtet e kontrates, pika 1.2, citohet se "1.2 Te pranoje kryerjen e gjithe sherbimit ne masen 5 % te vleres se tij te tenderuar prej bashkimit te operateve ekonomike dhe te vere ne dispozicion te bashkimit te operateve ekonomik ambientin ne te cilin do te kryhet sherbimi". Ne keto kushte kriteri i vendosur ne DST eshte plotesuar nga bashkimi i operateve ekonomik pasi BOE. (operatori ekonomik "Gustoso" dhe Ashiku Bland) ka vene ne dispozicion ambientin e tij dhe ka depozituar te gjithe dokumentacionin e nevojshem per plotesimin e ketij kriteri..".

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF, pretendimet e parashtruara ne ankesa mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se:

Per ofertuesin BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 31.07.2020, arsyet e skualifikimin te ofertes se tij si vijon: "BOE "Gustoso" + "Bland Ashiku", nuk ploteson nenpiken 2 te seksionit 3. 3 te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, pasi Operatori Ekonomik "Bland Ashiku" ne momentin e hapjes se ofertave, nuk arriti te paraqese dokumentacionin e kerkuar per ambientin ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit."

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF dhe konstatoi: Ne dokumentat e tenderit ne shtojcen nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.2 "Kapaciteti teknik" pika 2 percaktohet se Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient, ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit, per te cilin duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem: Dokumentacionin qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramanjen si me poshte: Dokumentacioni qe verteton pronesine-Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes/ose kontrata e dhurimit ose cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas

Kodit Civil te Republikës së Shqipërisë. Dokumentacioni që verteton huapërdorjen.- Kontratë huaje. Dokumentacioni që verteton marrjen me qirat - Kontratë qiraje. a) Licencën e kategorisë "II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë", leshuar nga Qendra Kornbetare e Biznesit. b) Leje e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, leshuar nga Qendra Kornbetare e Biznesit, për zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për këtë ambient. c) Akt miratimi higjieno - sanitar për këtë ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. d) Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. e) Operatori ekonomik duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezultoi se ofertesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF në përmbushje të kriterit të përcaktuar në shtojcën nr. 8 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" seksioni 3.2 "Kapaciteti teknik" pika 2, ka dorëzuar dokumentacionin me emërtim "Kontrata KM". Pjesë e këtij dokumentacioni janë kontrata e qirase së ambientit për qiramarrësin "Gustoso" SHPK, Licenca e kategorisë "II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë, Leja e mjedisit e tipit C, kodi III.1.A, Akti i miratimit higjieno - sanitar për këtë ambient dhe Certifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezultoi të jete dorëzuar dhe kontrata e bashkëpunimit për bashkimin e perkohshëm të operatoreve ekonomike me nr. Repertori 2860, nr. Koleksioni 905 datë 15/07/2020. Në kontratën e bashkëpunimit të dorëzuar është përcaktuar se shërbimi do të kryhet në masën 95 % nga "Bland Ashiku" PF dhe 5 % nga "Gustoso" SHPK. Në pikën 1.2 të kontratës është përcaktuar gjithashtu se shërbimi do të kryhet në ambientin e venë në dispozicion nga lideri në këtë bashkim operatorësh ekonomik, i cili rezultoi të jete anëtar i BOE "Gustoso" SHPK.

Për arsytet e mësipërme pretendimi i ofertuesit "BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF pranohet.

3. Ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF ka ankimuar skualifikimin për mospërmbushjen e kriterit në shtojcën nr. 8 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" seksioni 3.2 "Kapaciteti teknik" pika 4.1 në dokumentat e tenderit ku përcaktohet: "Punonjësit e punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Kuzhinier	2
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhinierë/Sherbyes gatimi	12
4	Shofer	2
	Total	17

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për kuzhinierin: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontratë pune, libër pune, libër shëndetsorë.

b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontratë pune, libër pune, libër shëndetsorë.

c) Për ndihmes kuzhinierë/Sherbyes gatimi: kontratë pune dhe libërat e punës, libër shëndetsorë.

d) Për shoferin: kontratë pune, libër pune dhe leje drejtimi mjeteve kategorisë - B.

e) Punonjesit me profesionet e mesiperme duhet te figurojne ne listpagesat e operatorit ekonomik per periudhen e kerkuar

me pretendimin si vijon: [...] "Ne lidhje me pretendimin e Autoritetit Kontraktor se nuk arriti te paraqese dokumentin origjinal apo kopje te noterizuar per kuzhinierin B.A bie ne kundershtrim me aktet ligjore si dhe praktiken e ndjekur deri me tani edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik. Ne zbatim të Manualit nr.1, date 26.01.2018 "Per regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit publik" thuhet se "Dokumentat e skanura duhet të jenë origjinale ose kopje të skanuara, version i skanuar I këtyre dokumentave pasi hidhet në sistemin e prokurimit elektronik, për një procedure konkrete është I barazvlefshem me dokumentin original". Dokumenti jone eshte skanuar ne versionin bardhe e zi dhe ne zbatim edhe me Udhezimin e APP nr. 3, date 09.05.2017 "Per shqyrtimin dhe Vleresimin e Ofertave me Prokurim me Mjete Elektronike" parashikohet se "Operatori ekonomik para se te lidhet kontrata i kerkohet te paraqese dokumentacionin administrativ ligjor ne forme te shkruar te paraqitur ne tender. Ky interpretim dhe qendrim eshte mbajtur edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik ne Vendimin e tij Nr.487/2018 ne te cilin shprehet se "Komisioni gjykon se procesi i dorezimit te dokumenteve prej operateve ekonomik ne SPE lidhet me konvertimin e tyre nga hard copy ne informacion dixhital (elektronik), informacion ky tashme i aksesueshem vetem nepermjet kompjuterit dhe per te cilin nuk ka kuptim gjykimi i origjinalitetit dhe askush nuk mund te gjykoje nese nje dokument ne format elektronik eshte kopje apo origjinale. Per me teper qe operatoret ekonomik ne procedurat e prokurimit ne te cilat marrin pjese, dorezojne deklarata mbi pergjegjesine qe ata mbajne per dokumentacionin qe paraqesin. 4. Persa i perket pretendimit se nuk ka depozituar dokumentacionin justifikues per dy shoferet, argumentojme se per keta punonjes BOE ka paraqitur lejet e drejtimit, kontrata pune dhe libreze pune per stafin e sipercitur. Pavaresisht se per nje nga punonjesit kontrata eshte lidhur per te kryer funksione si Kryekamariet, dokumentacioni i dorezuar ploteson kriterin pasi deshmohet qe punonjesit e stafit jane me kontrata te rregullta pune dhe kane deshmi per drejtimin e automjeteve sipas kategorive te kerkuara ne dst.

5. Se fundmi ne lidhje me pretendimin se Kuzhinieri/ndihmes kuzhinier/sherbyes gatimi K.H. D.L, D.H. E.T nuk arriti te provoje eksperiencen 1 vjecare te punes ju sqarojme se keta punonjes kane esperiencen e kerkuar ne dokumentat standard te tenderit dhe per te vertetuar kete fakt po ju veme ne dispozicion vertetimin e leshuar nga e-albania qe verteton se stafi e ploteson kete kriter. Duam te theksojme se oferta e shoqerise tone eshte me leverdi ekonomike se te giitha ofertat e tjera duke kursyer buxhetit te shtetit rreth 20,000,000 (njezet milion) milione leke. Persa me siper si dhe bazuar ne eksperiencen tone shumevjecare ne kete sektor duke realizuar me sukses kontrata te ngjashme ne sektorin publik kerkojme pranimin e kerkeses tone dhe kualifikimin e ofertes si te vlefshme dhe me cmimin me te ulet. "

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se:

Per ofertuesin BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 31.07.2020, arsyet e skualifikimin te ofertes se tij si vijon: "BOE "Gustoso" + "Bland Ashiku", nuk ploteson nenpiken 4.1 te seksionit 3. 3 te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, pasi Operatori Ekonomik "Bland Ashiku" ne momentin e hapjes se ofertave, nuk arriti te paraqese

dokumentacionin e kerkuar per dy shoferat; certifikaten e kualifikimit origjinale ose kopje te noterizuar te saj per kuzhinierin B.A.; ndersa per kuzhinierin K.H. dhe ndihmes kuzhinieret/ sherbyesit e gatimit D.L, D.H. dhe E. T nuk arriti te provoje eksperiencen 1 vjecare ne pune sipas profesioneve perkatese.

Komisioni i Shyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF dhe konstatoi:

Ne dokumentat e tenderit ne shtojcen nr. 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.2 "Kapaciteti teknik" pika 4.1 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: "Punonjesit e punesuar ne sektorin e sherbimit te ushqimit duhet te kene minimalisht 1 vit eksperience pune sipas profesioneve ne tabelen e meposhtme:

Nr	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	2
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhinier/Sherbyes gatimi	12
4	Shofer	2
	Total	17

Per punonjesit me profesionet e mesiperme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

f) Per kuzhinierin: diplome ose certifikate kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, libreze shendetsore.

g) Per mercollogun/kimistin/teknologun: diplorne ose certifikate kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, libreze shendetsore.

h) Per ndihmes kuzhinier/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, libreze shendetsore.

i) Per shoferin: kontrate pune, libreze pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria- B.

Punonjesit me profesionet e mesiperme duhet te figurojne ne listpagesat e operatorit ekonomik per periudhen e kerkuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF ne permbushje te kriterit te sipercituar ka dorezuar edhe dokumentacionet per stafin e kerkuar.

Nga verifikimi rezulton se ofertuesi ka dorezuar dy leje drejtimi, por personat per te cilet jane dorezuar lejet e drejtimit ne kontratat e punes dhe librezat e punes nuk figurojne si shofer, T.J figuron si motorrist ne libreze pune dhe si punonjes shperndarje ne kontrate pune, ndersa A.P figuron si kryekamariet ne kontrate pune dhe si kamariet ne libezen e punes. Ne kriter eshte percaktuar qarte se per shoferin ofertuesi duhet te dorezoje kontrate pune, libreze pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria - B.

Persa i perket arsyes se "certifikaten e kualifikimit origjinale ose kopje te noterizuar te saj per kuzhinierin B.A" sqarojme se ne dokumentat e tenderit percaktohet te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mos-dorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim.

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar rezulton se ne te njejtin folder jane dorezuar dokumente te skanuara me ngjyra nderkohe qe pjese tjeter e dokumentacionit te dorezuar ne po te njejtin folder eshte ne formatin bardhe e zi dhe ne asnje prej dokumenteve pa ngjyra nuk rezulton te jete i noterizuar. Ne dokumentat e tenderit percaktohet se te gjitha dokumentet e dorezuara si

pjese e ofertës, në përmbushje të kriterëve nga ofertuesit, duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rrerne e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në Manualin nr. 01, datë 26.01.2018 "Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik" të Agjencisë së Prokurimit Publik përcaktohet se: "Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për një procedurë prokurimi konkrete është i barazvlefshëm me dokumentin origjinal, ose kopjen e noterizuara."

Organi qendror blerës gjykon se është përgjegjësi e operatorit ekonomik ofertues të përgatitë dhe të dorëzojë ofertat në zbatim të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Ofertuesi përpara se të ngarkojë në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin pjesë të ofertës së tij, duhet të sigurohet që i gjithë dokumentacioni të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit të procedurës objekt prokurimi.

Përsa i përket eksperiencës së punës së stafit, me konkretisht për kuzhinierin K.H dhe ndihmes kuzhinieret/shërbyesit e gatimit D.L, D.H dhe E.T, ju bëjmë me dije se nga teresia e dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nuk vërtetohet se zoterojnë eksperiencën e kërkuar në shtojcën nr 8 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" seksioni 3.2, "Kapaciteti teknik" pika 4.1.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik se bashkëngjitur ankesës ka dorëzuar vërtetime të leshuara nga e-Albania, sqarojmë, komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe në zbatim të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nëni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 ku përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij nëni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nënit 54 të këtij ligji", ka bërë skualifikimin e ofertuesit BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF.

Për arsyet e më sipërme pretendimi i ofertuesit "BOE "Gustoso" SHPK dhe "Bland Ashiku" PF nuk pranohet.

II.7. Në datën 21.08.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Gustoso" sh.p.k. & "Bland Ashiku" p.f. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Kontraktor se nuk arriti të paraqesë dokumentin origjinal apo kopje të noterizuara për kuzhinierin B.A bie në kundërshtim me aktet ligjore si dhe praktiken e ndjekur deri me tani edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në zbatim të Manualit nr.1, datë 26.01.2018 "Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorzimin e ofertave në sistemin e prokurimit publik" thuhet se "Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje të skanuara, versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet në sistemin e prokurimit elektronik, për një procedurë konkrete është i barazvlefshëm me dokumentin origjinal".

Dokumenti jone është skanuar në versionin bardhë e zi dhe në zbatim edhe me Udhezimin e APP nr.3, datë 09.05.2017 "Për shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ofertave me Prokurim me Mjete Elektronike" parashikohet se "Operatori ekonomik para se të lidhet kontrata i kërkohet të paraqesë dokumentacionin administrativ ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender. Ky interpretim dhe qëndrim është mbajtur edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik në Vendimin e tij Nr.487/2018

ne te cilin shprehet se "Komisioni gjykon se procesi i dorezimit të dokumenteve te operatoreve ekonomik ne SPE lidhet me konvertimin e tyre nga hard copy ne informacion dixhital (elektronik), informacion ky tashme i aksesueshem vetem nepermjet kompjuterit dhe pet te cilin nuk ka kuptim gjykimi i origjinalitetit dhe askush nuk mund te gjykoje nese nje dokument ne format elektronik eshte kopje apo origjinale. Per me teper qe operatoret ekonomik ne procedurat e prokurimit ne te cilat marrin pjese, dorezojne deklarata mbi pergjegjesine qe ata mbajne per dokumentacionin qe paraqesin.

2. Persa i perket pretendimit se nuk ka depozituar dokumentacionin justifikues per dy shoferet, argumentojme se per keta punonjes BOE ka paraqitur lejet e drejtimit, kontrata pune dhe libeze pune per stafin e sipercitur. Pavaresisht se per nje nga punonjesit kontrata eshte lidhur per te kryer funksione si Kryekarnarier, apo dhe motorrist, dokumentacioni i dorezuar ploteson kriterin pasi deshmohet qe punonjesit e stafit jane me kontrata te rregullta pune dhe kane deshmi per drejtimin e automjeteve sipas kategorive te kerkuara ne dst. Lidhur me kete ceshtje kerkojme te sqarojme se Vendimi i KVO nuk eshte i qarte dhe se nuk perputhet qarte me kerkesat e dst pasi ne kriteret e kerkuara nuk kerkohet ne menyre eksplicite qe shoferet te kene kontrate te mirefillte me funksionin shofer por vetem kontrate pune. Gjithashtu sqarojme se per punonjes shofer automjeti, e kryen cdo person i cili eshte i pajisur me leje drejtimi, pra nuk eshte kontrata mes paleve qe i jep titullin drejtues mjeti por leja e drejtimit qe fitohet sipas legjislacionit ne fuqi per Kodin Rrugor.

3. Gjithashtu dhe per punonjesin me kontrate motorrist KVO nuk ka marre parsysh plotesimin e kriterit duke mos dhene arsye te bazuara. Terni i perdorur ne kontrate nuk i referohet vetem drejtimit te motorave por cdo mjeti te motorizuar qe ka nevojte shoqeria ku eshte punesuar.

4. Ne lidhje me pretendimin se Kuzhinieri/ndihmes kuzhinier/sherbyes gatimi K.H, D.L, D.H, E.T nuk arriti te provoje eksperiencen 1 vjecare te punes ju sqarojme se keta punonjes kane esperiencen e kerkuar ne dokumentat standard te tenderit dhe per te vertetuar kete fakt po ju veme ne dispozicion vertetirnin e leshuar nga e-albania qe verteton se staf e ploteson kete kriter. Duam te theksojme se vleresimi i bere bie ne kundershtrim me frymen e ligjit pasi ne nenin 53, pika 4, Ligji i Prokurimit Publik citohet se "Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigjohen pa prekur permbajtjen e saj."

Ne keto kushte sqarojme se punonjesit qe Autoriteti Kontraktor gjykon se nuk kane eksperiencen sipas kriterëve te percaktuar ne dst nuk qendron pasi deri ne momentin e lidhjes se kontrates keta punonjes arrijne te plotesojne kriterin per eksperiencen e kerkuar 1-vjecare edhe sikur dokumentacioni i kerkuar te mos merrej parasysh.

Duam te theksojme se oferta e shoqerise tone eshte me leverdi ekonomike se te gjitha ofertat e tjera duke kursyer buxhetit te shtetit rreth 20,000,000 (njetzet milion) milione leke. Autoriteti Kontraktor duhet te kishte vepruar ne perputhie me percaktimet dhe frymen e ligjit dhe pikerisht ne zbatim te nenit 1, pika 2/b, te Ligjit te Prokurimit Publik ne te cilin percaktohet se "te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale".

Persa me siper si dhe bazuar ne ekpriençen tone shumevjecare ne kete sektor duke realizuar me sukses kontrata te ngjashme ne sektorin publik kerkojme pranimin e kerkeses tone dhe kualifikimin e ofertes si te vlefshme dhe me cmimin me te ulet.

II.8. NËPËRMJET shkresës nr. 1693/1 prot., datë 01.09.2020, protokolluar me tonën në datën 04.09.2020, me objekt “Kthim përgjigje” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f. se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “*Persa i perket pretendimit se nuk ka depozituar dokumentacionin justifikues per dy shoferet, argumentojme se per keta punonjes BOE ka paraqitur lejet e drejtimit, kontrata pune dhe librezë pune per stafin e sipercitur. Pavaresisht se per nje nga punonjesit kontrata eshte lidhur per te kryer funksione si Kryekamarier, apo dhe motorrist, dokumentacioni i dorezuar ploteson kriterin pasi deshmohet qe punonjesit e stafit jane me kontrata te rregullta pune dhe kane deshmi per drejtimin e automjeteve sipas kategorive te kerkuara ne dst. Lidhur me kete ceshtje kerkojme te sqarojme se Vendimi i KVO nuk eshte i qarte dhe se nuk perputhet qarte me kerkesat e dst pasi ne kriteret e kerkuara nuk kerkohet ne menyre esplicite qe shoferet te kene kontrate te mirefillte me funksionin shofer por vetem kontrate pune. Gjithashtu sqarojme se per punonjes shofer automjeti, e kryen cdo person i cili eshte i pajisur me leje drejtimi, pra nuk eshte kontrata mes paleve qe i jep titullin drejtues mjeti por leja e drejtimit qe fitohet sipas legjislacionit ne fuqi per Kodin Rrugor.”*, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 4.1, e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

4.1 *Punonjësit e punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:*

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	2
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhinier/Shërbyes gatimi	12
4	Shofer	2
	Total	17

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) *Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetsore.*
- b) *Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetsore.*
- c) *Për ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, librezë shëndetsore.*
- d) *Për shoferin: kontratë pune, librezë pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.*
- e) *Punonjësit me profesionet e mësipërme duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhën e kerkuar.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f., rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin *”Kontratë Bashkëpunimi”*, ndërmjet shoqërisë “Bland Ashiku” p.f. dhe shoqërisë “Gustoso” sh.p.k., nga ku shoqëria “Bland Ashiku” p.f. merr përsipër të kryejë 95 % të shërbimit dhe shoqëria “Gustoso” sh.p.k. 5 % të shërbimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Gustoso” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f., konstatohet se ky i fundit, për të përmbushur kriterin e mësipërm ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Leje Drejtimi mjeti kategoria A B C BE CE, në emër të z.T.J.
- Kontratë punësimi, datë 05.01.2020 ndërmjet punëdhënësit Bland Ashiku dhe punëmarrësit Z. T.J, me detyrë *“Punonjës shpërndarje. Puna që do të kryejë punëmarrësi do të jetë shpërndan porosinë në adresat e klientëve”*.
- Librezë pune në emër të z.T.J, në të cilën pasqyrohet pozicioni i punës motorist, në shoqërinë “Bland Ashiku” p.f.
- Leje Drejtimi mjeti kategoria B, në emër të z.A.P
- Kontratë punësimi, datë 05.01.2020 ndërmjet punëdhënësit Bland Ashiku dhe punëmarrësit Z. A.P, me detyrë *“Krye Kamarier. Puna që do të kryejë punëmarrësi do të jetë kujdeset për mbarëvajtjen e punës dhe rakordimin e stafit”*.
- Librezë pune në emër të z.A.P, në të cilën pasqyrohet pozicioni i punës kamarier, në shoqërinë “Bland Ashiku” p.f.
- Listëpagesat e shoqërisë “Bland Ashiku” p.f. për periudhën Mars – Maj 2020.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të kenë në stafin e tyre 2 shoferë, për të cilët duhet të paraqesin dokumentat kontratë pune, librezë pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit si dhe kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, KPP, nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f. rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për punonjësit shofer. Konkretisht, nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Bland Ashiku” p.f., për plotësimin e kriterit në lidhje me dy shoferë ka paraqitur, Kontratë punësimi, datë 05.01.2020 ndërmjet punëdhënësit Bland Ashiku dhe punëmarrësit Z. T.J, me detyrë *“Punonjës shpërndarje. Puna që do të kryejë punëmarrësi do të jetë shpërndan porosinë në adresat e klientëve”*, shoqëruar me Librezën e punës në emër të z.T.J, në të cilën pasqyrohet pozicioni i punës së këtij të fundit si motorist, pranë shoqërisë “Bland Ashiku” p.f., si dhe lejen e drejtimit kategoria A B C BE CE. Gjithashtu, nga anëtari i bashkimit të përkohshëm të shoqërive, operatori ekonomik “Bland Ashiku” p.f. është paraqitur dokumenti Leje Drejtimi kategoria B, në emër të z.A.P, për të cilin është paraqitur Kontrata e punës, datë 05.01.2020 ndërmjet punëdhënësit Bland Ashiku dhe punëmarrësit Z. A.P, me detyrë *“Krye Kamarier. Puna që do të kryejë punëmarrësi do të jetë kujdeset për mbarëvajtjen e punës dhe rakordimin e stafit”*, si dhe Libreza e punës në emër të z.A.P, në të cilën pasqyrohet pozicioni i punës kamarier, në shoqërinë “Bland Ashiku” p.f. Ndërkohë për sa i përket, anëtarit tjetër të bashkimit të operatorëve ekonomikë, shoqërisë “Gustoso” sh.p.k., nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit, konstatohet se nuk është paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me kërkesën për shofer.

Sa më sipër, KPP gjykon se, asnjë prej anëtarëve të bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk plotëson kriterin në lidhje me kërkesën për dy shoferë, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në këtë bashkim.

Akoma më tej, vetë bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik pranon që për një nga shoferët e deklaruar, ka paraqitur kontratë pune me funksion kryekamarier.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mungesa e dokumentacionit të mësipërm do të sillte pamundësinë e realizimit me sukses të kontratës, pasi mjetet nuk do të kishin mundësi të qarkullonin.

III.1.8. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet*

konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.9. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi numri i shoferëve të kërkuar nuk plotësohet nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit. Sqarojmë se në kontratën e bashkëpunimit referuar legjislacionit në fuqi, operatorët ekonomikë të cilët vendosin të konkurrojnë si një bashkim operatorësh ekonomikë në një procedurë prokurimi, duhet ta zyrtarizojnë këtë bashkim nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, në të cilën kanë detyrimin të përcaktojnë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në këtë kontratë.

Nisur nga përqindja e përcaktuar në këtë kontratë, bëhet edhe verifikimi i përmbushjes së kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për shoferët, nuk është në përputhje me kërkesën e përcaktuar në dokumentat e tenderit, si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

III.1.10. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për punonjësit shoferë, për shkak të mangësive të evidentuara më sipër. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i

operatorëve ekonomikë ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.11. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se *“Pavaresisht se per nje nga punonjesit kontrata eshte lidhur per te kryer funksione si Kryekamariet, apo dhe motorrist, dokumentacioni i dorezuar ploteson kriterin pasi deshmohet qe punonjesit e stafit jane me kontrata te rregullta pune dhe kane deshmi per drejtimin e automjeteve sipas kategorive te kerkuara ne dst. Lidhur me kete ceshtje kerkojme te sqarojme se Vendimi i KVO nuk eshte i qarte dhe se nuk perputhet qarte me kerkesat e dst pasi ne kriteret e kerkuara nuk kerkohet ne menyre eksplicite qe shoferet te kene kontrate te mirefillte me funksionin shofer por vetem kontrate pune. Gjithashtu sqarojme se per punonjes shofer automjeti, e kryen cdo person i cili eshte i pajisur me leje drejtimi, pra nuk eshte kontrata mes paleve qe i jep titullin drejtues mjete por leja e drejtimit qe fitohet sipas legjislacionit ne fuqi per Kodin Rrugor”,* KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht dokumentacionin që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për të provuar profesionin e punonjësve, në rastin konkret të shoferit, kështu që rrjedhimisht në lidhje me pretendimin e mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”,* i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.* Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”,* i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f., për skualifikimin e padrejtë të tij, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur intereset e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gustoso” sh.p.k. & “Bland Ashiku” p.f., për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-58421-05-18-2020, me objekt Loti 6 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1030 (Forcat Tokësore)”, me fond limit 103.109.842 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1001 Protokolli

Datë 21.08.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri